

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Florentina Ademi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. J. nga Gj me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av....., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-s, dhe i akuzuari S. J nga Gj me mbrojtësin me autorizim ..nga Gj sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1068/2017, të datës 14.07.2017, të cilën e përfaqësonte Prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 21.07.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M**I.**

I pandehuri S. J, nga babai S, dhe e ëma A, e lindur I, i lindur më.., në ..Komuna e B, tani jeton në ... i pa martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar te ndërmarrja “Beli” në Prishtinë ka të kryer shkollën e mesme të tregtisë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar shetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i dënuar ndërsa nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 24 Qershor 2017, rreth orës 13,30 në shtëpinë e tij në, i pandehuri pas një fjalosje fillimisht verbale me vajzën e tij-të dëmtuarën M. J, të njëjtën e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht në pjesë të ndryshme të fytyrës të cilës i shkakton lëndime trupor dhe për ta ndërpre sulmin ndërhyjnë babai i të pandehurit S, i cili e godet me një shishe në kokë dhe fytyrë të pandehurit e parë, deri sa i pandehuri po ashtu e godet edhe prindin e tij i cili me këtë rast ka mare lëndime të lehta trupore, të përshkuara në raportet mjekësore me nr. 12806 dhe 12809 të dt. 24.06,2017 të lëshuar nga Qendra Emergjente e Spitalit Regjional në Gj.

me çka ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 45, 73, 75 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të akuzuarit S. J i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 83 të KP-s, të pandehurit S. J koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.06.2017 deri më 21.07.2017 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Të pandehurit S. J. i ndërprehet masa e paraburgimit me datën 21.07.2017 dhe i zëvendsohet me masën Ndalimi për tui afruar vendt apo personit të caktuar deri me datën 20.08.2017.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë çështje penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 21.07.2017, Prokurori i Shtetit Esat Ademi deklaroi, pas seancës së shqyrtimit fillestar duke u nisur nga fakti se i pandehuri edhe përkundër njoftimit nga gjykata për pasojat e pranimit të fajësisë i njëjti e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat tjera material të cilat gjenden në shkresat e lëndës fakte këto të cilat argumentojnë se i njëjti ka kryer veprën penale në tërësi siç është e përshkruar në dispozitiv e pare të kësaj aktakuze, dhe qëndroj pranë aktit akuzues dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban dhe propozoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Ndërsa për llojin dhe lartësinë e dënimit i propozoi gjykatës që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale si dhe natyrën e lëndimeve të shkaktuar të dëmtuarës me këtë veprë penale, e si rrethana rënduese të veçanti të merr parasysh se i njëjti është përsëritës i veprave penale të kësaj natyre, ka vendim gjyqësor për urdhër mbrojtje prindi i tij si dhe të merret parasysh sjellja e tij para dhe gjatë seancës, ndërsa sa i përket masës së paraburgimit ta vazhdoi këtë masë ngase të njëjtit nuk i dihet vendbanimi ngase i njëjti në këtë seance deklaroi se nuk dihet ku jeton.

E dëmtuara M. J., deklaroi: i bashkohem ndjekjes penale ndaj të pandehurit ndërsa nuk paraqes kërkesë pasuroro juridike por vetëm kërkoi që në të ardhmen i njëjti mos të na shqetësoi.

Mbrojtësi i të pandehurit .av.../deklaroi: meqenëse nga deklaratat e të pandehurit u kuptu se i njëjti e ka kryer veprën penale sipas aktakuzës duke shprehur njëkohësisht edhe pendim për veprimet të cilat i ka ndërmar në raport me prindin e tij dhe vajzën e tij, ku i njëjti i premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale të kësaj natyre ndaj anëtarëve të tij të familjes, ka premtu se do ta rrespektoi urdhërin e gjykatës, kërkoi nga Gjykata që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ta vlerësoi me seriozitet deklartën e të pandehurit që të i jep një dënim me kusht maksimal, e i cili dënim do të konsiderohet si sprovë e të njëjtit për të ardhmen që tani e tutje mos të kryej vepra tjera penale ndaj anëtarëve të familjes. Meqë i akuzuari gjendet në paraburgim konsideroi se në këtë fazë të procedurës kanë përfunduar të gjitha arsyerat ligjore për të cilat edhe është caktuar kjo masë, i propozoi gjykatës që ti ndërhehet masa e paraburgimit e duke ia zëvendësuar të njëjtën me masën e ndalimit të orfimit të vendit apo të personit të caktuar duke shpresuar që kjo masë megjithatë do ta arrijë qëllimin për parandalimin e veprave penale tani etutje.

I akuzuari, deklaroi: e ndiej vetën shumë fajtor për këtë veprë që ka ndodh dhe se jam penduar shumë për këtë veprë, dhe i premtoi gjykatës se ma kurrë nuk do të kryej veprë tjetër penale dhe po ashtu premtoi gjykatës se asnjëherë ma pa lejen e gjykatës nuk do të shkoj në shtëpinë e babait tim. Andaj kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës nga ana e PTH në Gjilan, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën e PTH dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit, të dëmtuarës dhe mbrojtësit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës penalisht.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarës dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore dhe lëndimi i shkaktuar të dëmtuarës dhe se i pandehuri është recidivist.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me 6 muaj burg, ndaj të akuzuarit, është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

II.

I akuzuari **S. J**, nga i ati H, dhe nëna H, e lindur D, i lindur me datë ..në f. Z Komuna e B, tani jeton në Gjilan.., i martuar baba i katër fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, deri më tani nuk ka qenë i dënuar.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datë 24 Qershor 2017, rreth orës 13,30 në shtëpinë e tij në, i pandehuri ka goditur në kokë dhe pjesë të fytyrës të pandehurin e parë S. J. me një shishe qelqi duke i shkaktuar të njëjtit lëndime të lehta trupore i cili për shkak të këtyre lëndimeve ka kërkuar ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gj.

me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke iu referuar marveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit, në bazë të neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPRK-s.

E GJYKON

Të akuzuarit S. J i shqiptohet denimi me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 30 ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të

përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbaramit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor dhe ka propozuar që pas mbajtjes së séances gjyqësore dhe shtjellimit të provave të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta denoj me denim meritor sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Esat Ademi, deklaron: Pas negocimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt. 20.07.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin i, ku i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marrëveshje dhe dënimin ta aprovojë dhe të gjykohen edhe të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

E dëmtuara, deklaroi, se nuk i bashkohem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, pasi që i njëjti nuk më ka sulmuar por i njëjti më ka mbrojtur e po ashtu nuk ushtroi kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit S.J., me autorizim av. ..deklaroi: propozoi që të aprovohet dënimi dhe marrëveshja e lidhur në mes të prokurorisë dhe të akuzuarit.

I pandehuri , deklaroi: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, dhe dua të shtoj se e ndiej veten fajtor dhe më vjen shumë keq për këtë që ka ndodhur.

Marveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i pandehuri ka bërë marveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i pandehuri dhe mbrojtësit i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që ti shqiptohet denim me gjobë në shumë prej

300(treqind) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 30 ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Bazuar në nenin 453 të KPPRK-ës Gjykata e obligoi të pandehurin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale. Përfaqësuesi i akuzës, i pandehuri dhe mbrojtësi i të pandehurit me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 706/2017 të datës 21.07.2017

Sek. Juridike,
Florentina Ademi **d.v**

Gjykatësi i vetëm gjykues,
Behar Ymeri **d.v**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit, pëmes kësaj Gjykate.